Shpërndanin kanabis dhe kokainë në qytet dhe kishin arsenal armësh në banesë, 2 në pranga në Korçë

14 Qershor, 2025 10:52

Madhësia e tekstit:

Dy persona kanë rënë në prangat e policisë së Korçës, pasi akuzohen për shpërndarje droge dhe për posedim të arsenalit të armëve.

Në kuadër të operacionit "Night sales" u arrestuan shtetasit Minella Pleqi dhe Gjergji Renja.

NJOFTIMI I POLICISË

Finalizohet pas 5 muajsh hetime proaktive, operacioni policor i koduar "Night sales", për qëditjen e veprimtarive kriminale në fushën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, armëmbajtjes pa leje dhe kultivimit të bimëve narkotike. U arrestuan shtetasit Minella Pleqi dhe Gjergji Renja.

Shpërndanin lëndë narkotike kanabis dhe kokainë në qytet, posedonin armë zjarri dhe municion luftarak në banesën e përbashkët të tyre, vihen në pranga 2 shtetas njëkohësisht edhe autorë të dyshuar të tentativës për kultivim të bimëve narkotike.

Specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve të DVP Korçë, bazuar në inteligjencën informative se dy shtetas në qytetin e Korçës, ushtronin aktivitetin kriminal të shpërndarjes së lëndëve narkotike, posedonin armë zjarri dhe municion pa leje si dhe në banesën e përbashkët të tyre, kishin kutivuar kanabis në gota plastike, kanë referuar materialet në Prokurori e cila regjistroi procedimin penal për rastin.

Pas një hetimi proaktiv të thelluar 5-mujor, të kryer nga Specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve të DVP Korçë në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, u organizua dhe finalizua me sukses operacioni i koduar "Night sales".

Si rezultat i këtij operacioni u kapën dhe arrestuan në flagrancë shtetasit:

-M. P., 22 vjeç dhe Gj. R., 32 vjeç, të dy banues në Korçë.

Shërbimet e Policisë kanë lokalizuar shtetasit e mësipërm në lagjen nr. 10, Korçë, ku gjatë kontrollit fizik të shtetasit M . P., dhe gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin tip "Rang Rover" në përdorim të shtetasit Gj. R., u gjetën disa doza me lëndë narkotike të dyshuar kanabis.

Në vijim të veprimeve të mëtejshme procedurale gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e marrë me qira nga këta dy shtetas, policia gjeti e sekuestroi në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri tip pistoletë; 2 krehra të armës së zjarrit; një sasi municioni luftarak; fidanë të kultivuar në gota plastike; 2 llamba neon led; 363.8 gramë lëndë e dyshuar narkotike kokainë; një sasi kanabisi e ndarë në doza, 1 peshore elektronike me mbetje të lëndës narkotike kokainë dhe një sasi lekësh që dyshohet se ishte siguruar nga kjo veprimtari.

Vijon puna për identifikimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të shtetasve të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Sanksionet e ndërkombëtarëve për Kosovën, mediat në Brukse\: Rrezikohet procesi liberalizimit të vizave
14 Qershor, 2023

EMRU/ Opozita bashkohet në Kavajë, merr krean e Këshillit Bashkiak. Betohet kryetari i ri (Video)
14 Qershor, 2023

Taboola Feed

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Comfort Siege | Sponsored
Play Now

This mineral will melt your belly fat fast
nuff Today review Healthspan | Sponsored

Vdes modelja që dëshmoi ndaj ish kryeministrit Silvio Berlusconi
Vdes modelja që dëshmoi ndaj ish kryeministrit Silvio Berlusconi
balkanweb.com

Top Scholarships In USA For Albania Students
USA Scholarships | Search Ads | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

U arrestua për bërje votash, kryebashkiaku Fredi Beleri kërkon lirinë, rekurs në Gjykatën e Lartë
14 Qershor, 2023

"Të dënohet autori", u përplas për vdekje nga një makinë, shokët e Enjo Sallajt protestë te Prokuroria
14 Qershor, 2023

"Më rrezikohet jeta", autorit të masakrës së Lushnjës i refuzohet kërkesa për azil, Lasert Hasholi do të ekstradohet në Shqipëri
14 Qershor, 2023

Ndiqte ambulancën për t'i ikur trafikut/ E pësoni shoferi 'i zgjuar', gjobë të majme nga policia, i hiqet dhe patenta
14 Qershor, 2023

Tragjika në Itali/ Rrëzohet nga shtylla e tensionit të lartë nga 40 metra larësi, humb jetën i riu shqiptar (EMRI)
14 Qershor, 2023

Dyshohet se përdoroj dhe përdhunoi të dashurën, arrestohet i ri\u nga Laçi
14 Qershor, 2023

KATEGORIA VIDEO

Fermerët në alarm, karkalecat 'pushtojnë' sipërfaqe të mëdha tokash në Sektor-Geman në Fier
Ervis Kaçi | 14 Qershor, 2023

"Nuk është lajmi i mirë për ne", kreu i komunës së Çjakovës flet për anulimin e mbledhjes së dy qeverive\: Nesër do të ishte një ditë e shënuar pasi...
14 Qershor, 2023

Shpërndanin kanabis dhe kokainë në qytet dhe kishin arsenal armësh në banesë, 2 në pranga në Korçë
14 Qershor, 2023

Dyshohet se do përdorej për trafik, gjendet brenda një kamioni me jonxhë gomonia 10 metra e gjatë
14 Qershor, 2023

U kap duke transportuar ilegalisht 10 emigrantë, kush është 42-vjeçari i arrestuar në Gjirokastër (EMRI)
14 Qershor, 2023

Gjendet vetëvra e braktisur në sipërfaqe ndërkombëtare, ankorohet në portin e Sarandës
14 Qershor, 2023

BW App Store | GET IT ON Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Sanksionet e ndërkombëtarëve për Kosovën, mediat në Brukse\: Rrezikohet procesi liberalizimit të vizave
14 Qershor, 2023

EMRU/ Opozita bashkohet në Kavajë, merr krean e Këshillit Bashkiak. Betohet kryetari i ri (Video)
14 Qershor, 2023

U arrestua për bërje votash, kryebashkiaku Fredi Beleri kërkon lirinë, rekurs në Gjykatën e Lartë
14 Qershor, 2023

"Të dënohet autori", u përplas për vdekje nga një makinë, shokët e Enjo Sallajt protestë te Prokuroria
14 Qershor, 2023

Mbytja e anijes me 400 emigrantë në brigjet helene, gjenden 59 trupa të pajetë
14 Qershor, 2023

"Liri, pavarësi, demokraci", Osmani e thotë në ti gjithë frazën e Rugovës në PE dhe zotohet për mbrojtjen e të drejtave të serbëve që jetojnë në Kosovë, e gjithë salla e duartrokat
14 Qershor, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.